

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, COVID-19 DHE PUNËSIMI

5 PIKA KRYESORE

1 Mbështetje e zgjidhjeve që promovojnë barazinë

Politikat e të punuarit nga shtëpia, duhet të sigurojnë që punonjësit me aftësi të kufizuara të kenë mjetet e duhura në shtëpi, ashtu siç i kanë/ do duhet t'i kishin në vendet e tyre të punës. Masat që merren si përgjigje ndaj Covid-19, të tilla si vetë- izolimi, duhet të llogarisin situatën e veçantë të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë dhe faktin, që disa prej tyre mund tu nevojitet ndihmë personale.

2 Komunikim i aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës për aftësinë e kufizuar

I gjithë komunikimi për shëndetin publik, edukimin dhe punësimin i lidhur me Covid-19, duke përfshirë këtu dhe rregullimet e nevojshme për punën në distancë, duhet të jetë i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë në gjuhën e shenjave, titra dhe uebsajte të aksesueshme. Komunikimi, duhet të adresojë gjithashtu situatën e veçantë të personave me aftësi të kufizuar

3 Mbrojtje sociale e përshtatshme

Mbrojtja sociale është thelbësore për personat me aftësi të kufizuara për të mbuluar kostot shtesë lidhur me aftësinë e kufizuar, të cilat mund të rriten për shkak të ndikimit të krizës dhe prishjes së sistemit të tyre të mbështetjes. Personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara, kanë përjetuar nivele të larta papunësie edhe përpara se të ndodhte kriza shëndetësore; tani, më shumë se kurrë masat e mbrojtjes sociale duhet të mbështesin personat me aftësi të kufizuara, të kenë tregues gjinorë dhe të krijohen në një mënyrë të tillë, që të mbështesin personat me aftësi të kufizuara që të përfshihen dhe të avancojnë në tregun e punës.

4 Të garantohet e drejta për punësim edhe gjatë periudhës së pandemisë

Në themel të lëvizjes për të drejtat e aftësisë së kufizuar dhe lëvizjes për të drejtat e punës, është dialogu dhe pjesëmarrja sociale. Kjo është e nevojshme më shumë se kurrë gjatë krizës aktuale. Një shumëllojshmëri pikëpamjesh nga qeveritë, organizatat e punëtorëve dhe punëdhënësve dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara, sjellin një shumëllojshmëri zgjidhjesh. Për të ndodhur kjo, është thelbësore zbatimi i standardeve ndërkombëtare të punës dhe instrumenteve të tjerë të të drejtave të njeriut, veçanërisht Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

5 Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në dialog për të ofruar zgjidhje përfshirëse

Thelbësore për të gjitha është përfshirja e personave me aftësi të kufizuara si bashkë-krijues të përgjigjeve ndaj Covid-19, si kampionë dhe përdorues, jo si viktime. Të gjitha krizat sjellin mundësi dhe mundësia e momentit është përfshirja e të gjitha grupeve të marginalizuara më parë – duke përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara si një element thelbësor në të gjitha përgjigjet.

Për të avancuar drejtësinë shoqërore dhe për të përfshirë në mënyrë domethënëse personat me aftësi të kufizuara, duhet të jemi të guximshëm. Ne duhet të jemi inovativë. Ne duhet të veprojmë së bashku - gjatë krizës së COVID-19 dhe më gjerë.

Ky dokument është përgatitur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadrin e projektit " COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar", të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë: <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.